



# **KOLEGJI I MENAXHMENTIT INTERNACIONAL – “GLOBUS”**

## **RREGULLORE PËR BORDIN INDUSTRIAL**

Prishtinë, 2020

## PËRMBAJTJA

<b>DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME</b> .....	4
Dispozitat hyrëse.....	4
Qëllimi .....	4
Akte të Bordin Industrial .....	4
Përbërja e Bordin .....	4
Zgjedhja e Anëtarëve të Bordin dhe Detyrat .....	5
Detyrat dhe Propozimet e Bordin .....	5
Takimet e Bordin .....	6
<b>VEPRIMTARIA E BORDIT</b> .....	6
Sugjerimet dhe Propozimet e Bordin.....	6
Miratimi i Propozimeve .....	7
Përcaktimi i Mandatit të Anëtarëve të Bordin .....	7
Hyrja në Fuqi .....	7
Shtojca .....	8

Në mbështetje të nenin xxx të Statutit të Kolegjit të Menaxhementit Internacional – “GLOBUS”, këshilli mësimor shkencor, në takimin e mbajtur më: xx.xx.xxxx ka analizuar Rregulloren për funksionimin e Bordit Industrial dhe i ka propozuar për aprovim Bordit Drejtues të Kolegjit. Bordi Drejtues i kolegjit në takimin e mbajtur më: xx.xx.xxxx, me propozim të këshillit mësimor shkencor mori:

## **VENDIM**

1. Për aprovimin e Rregullores për Bordin Industrial të Kolegjit të Menaxhmentit Internacional – “GLOBUS”
2. Këtij vendimi i bashkëngjitet Rregullorja e Bordit Industria të Kolegjit të Menaxhmentit Internacional – “GLOBUS”
3. Vendimi hynë fuqi menjëherë.

Vendimi t’i dërgohet:

1. Arkivit të Kolegjit
2. Menaxhmentit të Kolegjit
3. Sekretarit të Përgjithshëm

Mbi parimet e funksionimit të Bordit Industrial të Kolegjit të Menaxhmentit Internacional (në tekstin e mëtejme Kolegji GLOBUS)

## **DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME**

### **Dispozitat hyrëse**

Kjo rregullore përcakton karakteristikat, specifikat e anëtarësisë, funksionimit, fushën, mënyrën e vendimmarrjes dhe mandatin e Bordit Industrial të Kolegjit GLOBUS.

### **Qëllimi**

Bordi industrial, është themeluar në bazë të Statutit të Kolegjit të Menaxhmentit Internacional – GLOBUS dhe të kësaj rregullore, është jofitim prurës dhe këshilldhënës dhe, bazohet në vullnetin e mirë të anëtarëve dhe në përkushtimin e kolegjit për:

1. Për ngritjen e cilësisë së Arsimit të Lartë në fushën e Biznesit dhe Menaxhmit,
2. Bordi përbëhet nga akterët e tregut të punës dhe autoritetëve nga programet e dhe specializimet brenda Kolegjit GLOBUS dhe
3. Përbërja dhe aktivitetet e bordit industrial do të publikohen në ëeb-faqen e Kolegjit GLOBUS.

### **Neni 1**

#### **Akterët e Bordit Industrial**

Akterët relevant të cilët janë pjesë e themelimit dhe përbërës të këtij bordi:

1. Bordi do të themelohet nga Bordi drejtues i Kolegjit GLOBUS me propozimin e Rektorit.
2. Bordi përbëhet nga përfaqësues të të gjitha ndërmarrjeve dhe institucioneve me të cilat Kolegji GLOBUS ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi profesional.
3. Pas konstituimit të Bordit dhe zgjedhjes së Kryetarit, anëtarët e tjerë të Bordit mund të bashkohen gjithashtu.

### **Neni 2**

#### **Përbërja e Bordit**

Përbërja dhe struktura e bordit industrial konsiston në:

1. Bordi do të përbëhet nga përfaqësues të tregut të punës të cilët janë vendimmarrës në bizneset private (NVM-të) ose publike si dhe përfaqësues të autoriteteve qeveritare dhe joqeveritare që kanë të bëjnë me fushën e veprimtarisë së Arsimit të Lartë në Kosovë.
2. Anëtarët ex-officio të Bordit janë Rektori (me të drejtë vote), Prorektorë dhe Dekani i Kolegjit GLOBUS (pa të drejtë vote), si dhe një përfaqësues nga administrata (pa të drejtë vote).

3. Rektori përparitë mbledhjen themeluese të Bordit, përpilon materialet në lidhje me rendin e ditës dhe ndërmerr aktivitetet të tjera për mbarëvajtjen e punës së Bordit.

### **Neni 3**

#### **Zgjedhja e Anëtarëve të Bordit dhe Detyrat**

1. Bordi zgjedh Kryetarin nga radhët e përfaqësuesve të tregut të punës. Kryetari i Bordit udhëheq takimet dhe siguron që informacioni në lidhje me takimet t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve të tij dhe palëve të tjera të interesit.
2. Bordi gjithashtu, zgjedh Nënkryetarët e industrive/veprimtarive përkatëse (5 nënkryetarë të cilët duhet të jenë nga specializimet përkatëse). Këta nënkryetar së bashku me Kryetarin e Bordit do të drejtojnë takimet dhe anëtarët e industrive/veprimtarive përkatëse.
3. Kryetari i Bordit duhet të aplikojë qeverisjen korporative e praktikave më të mira dhe do të kujdeset për përmbledhjen e raporteve të punës së Bordit dhe operacionalizimin e iniciativave të tij.
4. Kryetari i Bordit do ta përfaqësojë atë në lidhje me palën e tretë. Në mungesë të kryetarit, ai / ajo mund të caktojë një zëvendës.
5. Kryetari i Bordit prezanton punën e Bordit në strukturat të ndryshme, siç janë: Këshilli Mësimor Shkencor, Këshilli Drejtues, institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, punëtori tematike, etj.
6. Bordi mund të krijojë grupe punuese që përqendrohen në fusha specifike të fushës së Kolegjit GLOBUS.
7. Në varësi të temave që do të diskutohen, Bordi i Drejtorëve, Drejtori i Institutit për Hulumtime - GLOBUS dhe përfaqësuesit e organeve përkatëse që veprojnë brenda Kolegjit GLOBUS mund të ftohen në mbledhjet e Bordit pa të drejtë vote.

### **Neni 4**

#### **Detyrat dhe Propozimet e Bordit**

1. Bordi mund t'i sugjerojë Këshillit Mësimor / Shkencor dhe Bordit Drejtues të Kolegjit GLOBUS rifreskimin e programeve të studimit, si dhe specializimet e reja, në përputhje me nevojat e tregut.
2. Anëtarët e bordit mbështesin realizimin e praktikës profesionale të studentëve të Kolegjit GLOBUS, në përputhje me programet e studimit.
3. Bordi do të mbështesë Kolegjin GLOBUS dhe akterët tjerë në krijimin e grupeve të përbashkëta të punës.
4. Bordi dhe Kolegji GLOBUS do të bashkëpunojnë në kërkimin shkencor, shërbimet profesionale, bashkëpunimet në projekte, ndërmjetësimin në inovacion, si dhe në propozimet për bashkëpunim në projekte të përbashkëta me Kolegjin dhe partnerë të tjerë.
5. Anëtarët e bordit mund të sigurojnë bursa për studentë si dhe mbështetje financiare për studentë dhe projekte kërkimore akademike.

6. Bordi gjithashtu mund të shqyrtojë çështje të tjera të propozuara nga Rektori

## **Neni 5**

### **Takimet e Bordit**

1. Bordi duhet të mblidhet të paktën dy herë në vit dhe të paktën brenda dhjetë ditëve nga fillimi i vitit akademik dhe përfundimit të tij.
2. Bordi, me kërkesë të së paku 15 anëtarëve, mund të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme ku marrin pjesë së paku 50% e tyre.
3. Nëse Kryetari ose Zëvendëskryetari nuk e thërrasin mbledhjen për ndonjë arsye apo tjetër, mbledhja mund të thirret sipas paragrafit 2 të këtij neni, por ajo drejtohet nga anëtari më i vjetër që merr pjesë në mbledhje. Ky takim mund të thirret vetëm një herë.
4. Në raste të tjera kur ka pengesa në thirrjen dhe organizimin e takimit, Kolegji GLOBUS mund ta ushtrojë këtë të drejtë.
5. Me kërkesë të Anëtarëve të Bordit ose të Kolegjit, në raste specifike, takimi mund të thirret vetëm me anëtarët e industrisë/veprimtarisë brenda një programi. Anëtarët e tjerë të Bordit njoftohen me e-mail për rekomandimet e takimit.
6. Mbledhjet e Bordit do të thirren të paktën tre ditë para datës së takimit nga Kryetari.
7. Në mungesë të Kryetarit, mbledhjet thirren nga një Zëvendës Kryetar i programit përkatës dhe në raste të tjera nga Zëvendës Kryetari.
8. Në çdo mbledhje të Bordit, lista e pjesëmarrësve nënshkruhet si dhe procesverbalet e takimit.
9. Materialet e takimit duhet të ruhen si dokumente të rëndësishme në administratën e Kolegjit.

## **VEPRIMTARIA E BORDIT**

### **Neni 6**

#### **Sugjerimet dhe Propozimet e Bordit**

Bordi industrial/veprimtarive mund të sugjerojë apo propozojë:

1. Bordi mund të sugjerojë ndryshimin, përmirësimin, rifreskimin e rregulloreve dhe akteve tjera normative të zbatueshme.
2. Bordi mund t'i propozojë Këshillit Mësimor / Shkencor dhe Këshillit Drejtues programe në lidhje me: të mësuarit gjatë gjithë jetës, trajnimin e të rriturve dhe aftësimin profesional.
3. Bordi do të bëjë vlerësime, rekomandime dhe sugjerime në lidhje me kushtet e punës, laboratorët dhe lehtësimin e funksionalizimit të punës.
4. Këshillat dhe sugjerimet e Bordit për çështjet e adresuara do t'i drejtohen Këshillit Mësimor / Shkencor, Menaxhmentit dhe Këshillit Drejtues të Kolegjit Globus në kontekstin e:

hartimit të programeve të reja, respektivisht specializimeve, angazhimin në procesin e akreditimit, caktimit të punës praktike, planifikimit të projekteve kërkimore.

#### **Neni 7**

#### **Miratimi i Propozimeve**

1. Propozimet miratohen nga një shumicë e thjeshtë e anëtarëve të pranishëm (50% plus një).
2. Rekomandimet e Bordit, në formën e një propozimi, do t'i paraqiten Këshillit Mësimor / Shkencor për procedim të mëtejshëm.

#### **Neni 8**

#### **Përcaktimi i Mandatit të Anëtarëve të Bordit**

**Bordi industrial/veprimtarive** kohëzgjatjen e mandatit e kanë si në vijim:

1. Mandati i anëtarëve të Bordit është katër (4) vjet, me mundësinë e rizgjedhjes. Numri i vendeve nuk është i kufizuar.
2. Me ftesë të Rektorit, Kryetari i Bordit mund t'i paraqesë Këshillit Mësimor Shkencor dhe Bordit Drejtues të Kolegjit aktivitetet e Bordit për një periudhë të caktuar.

#### **Neni 9**

#### **Hyrja në Fuqi**

Kjo rregullore do të hyjë në fuqi në ditën e aprovimit të saj nga Këshilli Drejtues i Kolegjit GLOBUS.

Kryetari i Këshillit Drejtues  
Emri dhe Mbiemri

---

Nënshkrimi

**Shtojca 1: Formulari për nominimin e kryesuesit të Bordit.**



**Formulari për nominimin e Kryesuesit të Bordit Këshilldhënës**

Emri dhe Mbiemëri i anëtarit të Bordit.	
Emri dhe Mbiemëri i anëtarit të Nominuar	
Cilësitë/ Atributet e anëtarit të Nominuar.	
Qëllimi dhe arsyeja e Nominimit. <ul style="list-style-type: none"><li>- Cili do të jetë kontributi?</li><li>- Cilat janë sukseset e arritura të tij?</li><li>- Cilat janë pritjet në këshillime?</li></ul>	